



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE  
KËSHILLI DREJTUES

V E N D I M

Nr. 8 datë 21.03.2019

PËR

**“DHËNIEN E MIRATIMIT PARAPRAK PËR KRYERJEN E TRANSAKSIONIT  
TË PRITSHËM PËR SHITJEN E AKSIONEVE TË SIPËRMARRËSIT  
TELEKOM ALBANIA SH.A.”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

<b>Z.</b>	<b>Illir Zela</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Znj.</b>	<b>Ketrin Topçiu</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Znj.</b>	<b>Edlira Dvorani</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Znj.</b>	<b>Xhoana Lilaj</b>	<b>Anëtare</b>

dhe sekretare Znj. Hasime Ferati, në mbledhjen e datës 21.03.2019, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr.9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të Këshillit Drejtues të AKEP, miratuar me Vendimin nr.7 datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

- **Dhënien e miratimit paraparak për kryerjen e transaksionit të pritshëm për shitjen e aksioneve të sipërmarrësit “Telekom Albania sh.a.”.**

**BAZA LIGJORE:**

1. Neni 114, dhe neni 115, të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (**ligji nr. 9918/2008**);
2. Ligj nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë” (**ligji nr. 44/2015**);
3. Neni 7, i Rregullores Nr.30, datë 05.12.2013, “Dhënien e Autorizimit Individual për përdorimin e frekuencave”, (**Rregullore nr.30**);
4. Rregullore e Brendshme “Për Funkcionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare”, miratuar me Vendimin nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, (**Rregullore nr.7**).

## **K Ë SHILLI DREJTUES:**

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të përbërë si më poshtë:

1. Relacioni shpjegues i Projekt VKD;
2. Projekt Vendimi i arsyetuar.
3. Shkresa nr.508/2, datë 13/02/2019, e sipërmarrësit “Telekom Albania sh.a.”;
4. Shkresa nr.508/4, datë 08/03/2019, e sipërmarrësit “Telekom Albania sh.a.”;

si edhe pasi e diskutoi në tërësi çështjen,

## **V Ë R E N:**

### **I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Me shkresën nr.508/2, datë 13/02/2019, të sipërmarrësit “Telekom Albania sh.a.”, AKEP është vënë në dijeni zyrtarisht mbi lidhjen e Marrëveshjes së Shit-blerjes të datës 16.01.2019, të aksioneve të shoqërisë “Telekom Albania sh.a.”, një shoqëri e cila ushtron veprimtari sipas legjislacionit shqiptar, transaksion i cili ka për synim transferimin e të gjitha aksioneve të zotëruara nga shoqëria “Cosmote Mobile Telecommunications S.A.” (99.757%), një shoqërie e themeluar dhe e regjistruar në shtetin Grek, tek shoqëria “Albania Telecom Invest AD”, një shoqëri e themeluar dhe e regjistruar në shtetin Bullgar.
2. AKEP, në vijim të shkresës zyrtare të sipërmarrësit “Telekom Albania sh.a.”, duke gjukuar të nevojshëm plotësimin e informacionit të paraqitur dhe me aktet vendimarrëse të secilës nga organet drejtuese të shoqërive të përfshira në procesin e Shitblerjes së aksioneve të “Telekom Albania sh.a.”, ka kërkuar nëpërmjet shkresës nr.688/59, datë 20/02/2019, vënien në dispozicion të vendimeve respektive të organeve drejtuese të palës shitëse dhe blerëse përkatësisht, të shoqërisë “Cosmote Mobile Telecommunications S.A” dhe të shoqërisë “Albania Telecom Invest AD”, si dhe të deklaratës së aksionerëve të rinj, të palës blerëse, se nuk ndodhen në kushtet e zotërimit të aksioneve në shoqëri të tjera të cilat ushtrojnë veprimtari të njëjtë në Republikën e Shqipërisë sipas përcaktimeve të Ligjit nr.9918/2008.
3. Me shkresën nr. 508/4, datë 08/03/2019, sipërmarrësi “Telekom Albania sh.a.” ka përcjellë pranë AKEP vendimet e Bordeve Drejtuese të shoqërive të përfshira në këtë proces, në të cilat është shprehur qartë qëndrimi për miratimin e shitblerjes së aksioneve të shoqërisë “Telekom Albania sh.a.”, si dhe të Deklaratës të datës 05.03.2019, të përfaqësuesve ligjorë të shoqërisë “Albania Telecom Invest AD”, se as kjo shoqëri dhe as aksionerët e saj nuk zotërojnë aksione ose pjesëmarrje të drejtëpërdrejtë apo të tërthortë në tregun e komunikimeve elektronike në Shqipëri.

## II. VLERËSIMI I KËSHILLIT DREJTUES

1. Në referim të pikës 3 dhe 4, të nenit 7, të Rregullores nr.30, si dhe të kushteve të vendosura në Autorizimet Individuale që janë lëshuar për sipërmarrësin “Telekom Albania sh.a.”, konstatohet se AKEP ruan të drejtën e miratimit paraprak për çdo transaksion të mundshëm të aksioneve të shoqërisë që mund të çojë në ndryshim të pronësisë për më shumë se 50 % të kapitalit themelues të deklaruar nga sipërmarrësi. Realizimi i procedurës së miratimit paraprak, në vlerësim të KD-së të AKEP, është i lidhur ngushtësisht me përmbushjen e disa kushteve/kritereve të përcaktuara në Rregulloren nr.30, si dhe në Autorizimet Individuale të lëshuara për sipërmarrësin “Telekom Albania sh.a.”. Konkretisht, kriteret kryesore për të cilat investohet AKEP përgjatë vlerësimit dhe zhvillimit të një procedure të miratimit paraprak të kalimit të aksioneve nga një shoqëri në një tjetër, është verifikimi nëse shoqëria blerëse apo aksionerët e saj, zotërojnë aksione ose kanë pjesëmarrje të drejtëpërdrejtë apo të tërthortë në shoqëri të tjera që ushtrojnë aktivitet të njëjtë në Shqipëri, si dhe vlerësimi nëse një transaksion i mundshëm do të sillte apo jo shkelje të kushteve të Autorizimeve Individuale.
2. Në këto kushte, Këshilli Drejtues i AKEP gjykon së pari të konsideroj të plotë informacionin e depozituar nga sipërmarrësi “Telekom Albania sh.a”, dhe se në vlerësim të këtij informacioni por dhe i të dhënave që disponohen nga strukturat përgjegjëse pranë AKEP të ngarkuara për administrimin e regjistrave të sipërmarrësve të shërbimeve dhe rrjeteve të komunikimeve elektronike, rezulton se as shoqëria blerëse “Albania Telecom Invest” AD, si dhe as aksionerët e saj nuk zotërojnë aksione apo të jenë pjesëmarrës në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo të tërthortë në shoqëri të tjera të cilat ushtrojnë aktivitet në fushën e telefonisë së lëvizshme në Republikën e Shqipërisë.  
Sa më sipër, mbështetet në Deklaratën e datës 05.03.2019, të përfaqësuesve ligjorë të shoqërisë “Albania Telecom Invest AD”, të cilët kanë deklaruar se as kjo shoqëri dhe as aksionerët e saj, nuk janë aktiv në Shqipëri dhe nuk zotërojnë aksione ose pjesëmarrje në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo të tërthortë në tregun e komunikimeve elektronike në Shqipëri.
3. Në vijim, Këshilli Drejtues i AKEP thekson se në vlerësim të legjislacionit në fuqi që rregullon konkurrencën e lirë dhe efektive në treg, mbetet në kompetencë të Autoritetit të Konkurrencës, si institucion përgjegjës për mbrojtjen e konkurrencës efektive, vlerësimi apo verifikimi nëse marrëveshja e lidhur midis dy shoqërive paraqet kushtet apo riskun e kufizimit apo dëmtimit të konkurrencës në treg.

### P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Në mbështetje të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 114, neni 115 i Ligjit Nr. 44/2015 si dhe në zbatim të Rregullores të miratuar me Vendimin nr.7 datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP “Për Funksonimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike” të ndryshuar, Këshilli Drejtues i AKEP,

## V E N D O S I:

1. Të japë miratimin paraprak të kryerjes së transaksionit të pritshëm për shitjen e aksioneve të sipërmarrësit “Telekom Albania sh.a.”, të zotëruara nga shoqëria “Cosmote Mobile Telecommunications S.A” tek shoqëria “Albania Telecom Invest AD”, përkatësisht sipas vendimeve të organeve drejtuese të shoqërive të mësipërme.
2. Ngarkohet Drejtoria e Autorizimeve për njoftimin e këtij vendimi sipërmarrësit “Telekom Albania sh.a.”.
3. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: [www.akep.al](http://www.akep.al).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Kryetar**  
**Ilir ZELA**

**Anëtar**  
**Edlira DVORANI**

**Anëtar**  
**Ketrin TOPÇIU**

**Anëtar**  
**Xhoana LILAJ**